



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

Data: 06.07.2017 Ref.: 541/17

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 51-të, të mbajtur më 23 Qershor 2017, mori:

V E N D I M

- I. Akreditohet programi i studimit i Fakultetit Filologjik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2017 – 30 shtator 2020:
 - Gjuhë dhe Letërsi Gjermane, MA, 60 ECTS, maksimumi 20 studentë për vit akademik.
- II. Obligohet Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti Filologjik që deri me 1 tetor 2017 në Agjencinë e Kosovës për Akreditim ta dorëzoj planin e rekrutimit të stafit akademik, për vitin akademik 2017/2018, për arsyeje të pensionimit të mundshëm të stafit, apo për çfarëdo arsyeje tjetër.
- III. Obligohet Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti Filologjik që deri me datë 1 dhjetor 2017 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti Filologjik ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për akreditim të programit të studimit: Gjuhë dhe Letërsi Gjermane, MA, 60 ECTS me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Gjuhë dhe Letërsi Gjermane	MA	60	Albulena Blakaj Gashi, Naser Mrasori, dhe Milote Sadiku

AKA ka organizuar vizitën në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” më 04.11.2016, me qëllim të vlerësimit të programit të studimit të cekur më sipër me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Volker Frederking dhe Joern Brueggemann.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 23 qershor 2017 ka shqyrtuar aplikacionin e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakultetit Filologjik, dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesë për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakultetit Filologjik;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë